



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:050455

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05697467

KPPP.nr. 308/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.T.P “Adriatik Commerce” me numër unik identifikues 80128576 dhe me seli në Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Firma Ligjore ICL Law me seli në Prishtinë, kundër debitorit Administrata Tatimore e Kosovës-Njësia në Gjilan, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 10/2024 të datës 18.01.2024, të Përmbartuesit Privat Irfan I. Kërçagu, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 16.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Administrata Tatimore e Kosovës-Njësia në Gjilan, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 10/2024 të datës 18.01.2024 i lejuar nga Përmbartuesi Irfan I. Kërçagu, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.T.P “Adriatik Commerce”, në bazë të titullit ekzekutiv Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale në Kosovë, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KE.nr. 1717/22 i datës 03.03.2023, i vërtetuar sipas Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, K.Dh.Shk.II.nr. 813/2023 i datës 13.11.2023, me datë 18.01.2024 ka nxjerr urdhrin P.nr. 10/2024 me të cilin ka detyruar debitorin, t’ia paguaj borxhin në shumën prej 7,989,90 EUR (shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë euro e nëntëdhjetë cent) me kamatë ligjore prej 8% nga dita e caktimit të përmbartimit e deri në pagesën definitive përfundimtare nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm, me përmbartimin e mjeteve monetare në llogaritë bankare të debitorit, dhe regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin, dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të

debitorit, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore sipas tarifës së OAK-së dhe shpenzimet procedurale për përpilimin e propozimit për përbarim.

Debitori në prapësimin e paraqitur ka deklaruar se urdhri përbarimor i cili ka objekt ekzekutimin e aktgjykimit të shkallës së dytë sipas propozimit përbarimor përfshin ekzekutimin e shumës prej 7,104.90 EUR, ekzekutim i cili nuk mund të bëhet nga Përbaruesi Privat në asnjë formë, meqë ekzekutimi në fjalë duhet të bëhet dhe mund të bëhet vetëm në procedurë të brendshme nga vetë debitori Administrata Tatimore e Kosovës. Po ashtu ka theksuar se në këtë rast kemi të bëjmë me përbarim të mjeteve të cilat janë të përjashtuara nga përbarimi i detyrueshëm dhe i zakonshëm, si shkak për prapësim sipas nenit 71 pika 1.5 të LPP-së. Andaj i ka propozuar gjykatës që ta anuloj Urdhrin për Përbarim P.nr.10/24 datë 18.01.2024 të lejuar nga Përbaruesi Privat Irfan I. Kërçagu.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar prapësimin e debitorit duke deklaruar se pretendimet e debitorit janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara, pasi që prapësimin e tij nuk e ka mbështetur në asnjë pikë të nenit 71.1 të LPP-së dhe nuk ka parashtruar asnjë arsye ligjore që prapësimi i tij të aprovohet. Andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit si i pa bazuar, të mbetet në fuqi Urdhri Përbarimor P.nr.10/24 i datës 18.01.2024 i lejuar nga Përbaruesi Privat, si dhe të aprovohen shpenzimet sipas udhëzimit administrativ për shpenzimet e përbaruesit privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përbarues ka lejuar përbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përbarimor, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Komerciale në Kosovë, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KE.nr.

1717/22 i datës 03.03.2023, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.1 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi. Gjykata gjeti se i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, objektin e detyrimit të debitorit dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale në Kosovë, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KE.nr. 1717/22 i datës 03.03.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara edhe me nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”* ngase i njëjti është pajisur me klauzolë të përmbarueshmërisë sipas të cilës rezulton se aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm me datë 13.11.2023 dhe i ekzekutueshëm nga data 10.01.2024.

Gjykata, me rastin e vendosjes i vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përmbarues mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të së cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22 dhe 27 të LPP-së.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08 L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 308/24, datë 16.05.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.